



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Doretuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	24-10	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinitca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	6672/2023		113



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1149/2023

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Sabile Avdyli, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës A.nr.852/2023, të datës 15.06.2023, të parashtruar nga ankuesja [redacted] të cilën më autorizim e përfaqëson [redacted] avokat nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Ministria e Shëndetësisë, në çështjen juridike "*kompensim material*", duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1; nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.4; të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.10.2023, njëzëri mori këtë:

### V E N D I M

**I. Detyrohet** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të shqyrtoj kërkesë-ankesën e ankueses me numër protokolli 05-4724, të datës 03.08.2023, si dhe të nxjerr akt administrativ në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

**II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Ankuesja [redacted] (*tutje vetëm ankuesja*), më datë 07.09.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Shëndetësisë, për shkak të mos harmonizimit të koeficientit lidhur me pozitën e Zëvendësës së Kryeinspektorit të Inspektoratit Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë si dhe kompensimin në mënyrë retroaktive të diferencës së koeficientit nga pozita e nivelit të mesëm drejtues në pozitën e nivelit të lart drejtues nga data e Vendimit me Nr.178/XII/2022 të datës 22.12.2022. Pretendon se organi i punësimit ka bërë aplikim të gabuar së drejtës materiale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje të dispozitave të procedurës administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*këtu e tutje Këshilli*), bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për



Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.09.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Shëndetësisë, ndërsa, kjo e fundit, më datë 14.09.2023, ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në procedurë të vendosjes.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:* Ankesën me numër të protokollit 6005/2023, të datës 07.09.2023, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Autorizimin e datës 28.07.2023 për përfaqësim; E-mail e datës 08.08.2023 nga Menaxheri i Personelit -kërkesë për opinion ligjor për Drejtorin e DMZP-së; Vendimin me Nr.178/XII/2022, të datës 22.12.2022, të Ministrisë të Shëndetësisë për caktimin e zëvendësues së Kryeinspektorit në Inspektoratin Shëndetësor, në Ministrinë e Shëndetësisë; Ankesën me nr.05-4724, të datës 03.08.2023 të parashtruar nga ankuesja në Zyrën e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë; Vendimin A.nr.332/2023. me numër protokollit 3121/2023 të datës 29.03.2023, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Llogarinë bankare për muajin qershor 2023 të ankueses; Shtojcën Nr.10.5-Institucionet e Pavarura Kushtetuese; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 12.09.2023 nga Këshilli për organin e punësimit; Përgjigjen në ankesë e datës 14.09.2023 nga organi i punësimit; Akt emërimit me Nr.170 të datës 01.01.2017 dhe E-mailin e datës 13.07.2023 nga Menaxheri i Personelit në Ministrinë e Shëndetësisë për Drejtorin e DMZP-së.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit të shkresave të lëndës, konstatoi që lënda të kthehet në shqyrtim të organi i punësimit, me obligimin që Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë e Shëndetësisë të shqyrtoj kërkesën/ankesën e ankueses të datës 03.08.2023 dhe të nxjerrë vendim në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, *sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë së ankuesja [redacted] është e punësuar në Inspektoratin Shëndetësor brenda Ministrisë së Shëndetësisë, dhe së e njëjta sipas Aktit të Emërimit me numër 170 të datës 01.11.201, mbanë pozitën e punës Inspektor Shëndetësor.

Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton së me Vendimin me Nr.178/XII/2022 të datës 22.12.2022, të Zv. Ministres së Ministrisë së Shëndetësisë, ankuesja nga pozita e Inspektore Shëndetësore është caktuar Zëvendësuese e Kryeinspektorit të Inspektoratit Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë, pa afat të përcaktuar të zëvendësimit.

Ankuesja me datë 03.08.2023, parashtron ankesë/kërkesë me numër protokollit 05-4724, pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Shëndetësisë, me kërkesë që t'i njihet e drejta e harmonizimit të koeficientit të pagës nga niveli i mesëm në nivelin e lartë drejtues dhe kompensimi në mënyrë retroaktive të diferencës së koeficientit të pagës nga niveli i mesëm në nivelin e lartë drejtues dhe atë nga data e nxjerrjes së Vendimit me Nr.178/XII/2022 të datës 22.12.2022.

Ankuesja për shkak të mos përgjigjes së organit të punësimit në kërkesën-ankesën e datës 03.08.2023, parashtron ankesë në Këshill, me kërkesën që Këshilli të vendos meritorisht lidhur me këtë çështje, rrjedhimisht, që Këshilli të aprovoj ankesën e ankueses si të bazuar dhe të obligoj Ministrinë e Shëndetësisë për harmonizim të koeficientit të pagës së ankueses dhe kompensim në mënyrë retroaktive të diferencës së koeficientit të pagës nga niveli i mesëm në nivelin e lartë drejtues dhe atë nga data e nxjerrjes së Vendimit me Nr.178/XII/2022 të datës 22.12.2022.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore Kolegji i Këshillit i'u referua Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht dispozitave të nenit 83 me të cilin përcaktohet se: *Procedura administrative fillon sipas kërkesës të palës apo sipas detyrës zyrtare nga organi publik, nenit 97 paragrafi 1 më të cilin parashihet se: Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative, si dhe nenit 98 ku thuhet se: 1.*





Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj. 3. Nëse me ligj parashihet detyrimi i palës për të parashtruar një dokument apo për të kryer një veprim procedural, si pjesë apo së bashku me parashtrimin e kërkesës për fillimin e procedurës, afati i përcaktuar në pajtim me paragrafin 1 ose 2 të këtij neni, do të fillojë të llogaritet nga parashtrimi i dokumentit apo kryerja e veprimit procedural përkatës”, andaj, mbi këtë bazë ligjor, e duke qenë së organi i punësimit në këtë rast Ministria e Shëndetësisë nuk ka shqyrtuar kërkesën-ankesën e ankueses të datës 03.08.2023, rrjedhë detyrimi që Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë si Zyrtari me i Lartë Administrativ që brenda afatit si në dispozitiv të këtij vendimi, të shqyrtoj kërkesën e ankuesit të datës 03.08.2023 dhe të nxjerr akt administrativ në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe të njëjtin t’ia komunikoj palës ankuese siç përcaktohet me nenin 118 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.


Theksuar si me sipër, e në kuptim të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1149/2023

Sabile Aydyli

  
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

  
Kryetare e Kolegjit



### Vendimi i dërgohet:

- Avokatit [redacted]
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

